



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

ZL.Anr.380/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi, anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fjolla Elshani nga Iniciativa e të Pavarurit e Istogut, me seli në Istog, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV), në Istog, për shkak të parregullsive në Vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL.Anr.380/2017 e datës 23.10.2017 e Fjolla Elshani, nga Iniciativa e të Pavarurit e Istogut, me seli në Istog.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 23.10.2017 nga Fjolla Elshani, nga Iniciativa e të Pavarurit e Istogut, me seli në Istog, me të cilën pretendon se ka dyshime se në disa qendra të votimit (QV), në Istog nuk është bërë numërimi korrekt i votave. Kërkon nga Paneli që të bëhet rinumërimi i votave në disa QV në Istog.

Ankesës i ka bashkangjitur një listë të shënuar me QV-të ku mendon se i mungojnë votat.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljes e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ta hedh si të palejuar ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpallja së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 380/2017 me datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Paneli
Zyhet Haziri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-